



KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-2643

Pejë, datë: 20 Janar 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i I- i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **20 janar 2025**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ZKF znj.Hajrije Haxhijaj,Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, Asistente e kryesuesit, znj.Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë.

Z.Labinot Panxha: sa i perket rendit të dites këtu mungon pika e 8 mungon por ajo është e pa rendësishme! Qendrimi jonë si Aleancë është të mos marrim pjesë në votim, duke pas parasysh se votat e tona kunder nuk po vlersohen dhe pikat e caktuara të rendit të dites po i rekomandohen kuvendit pa shumicën e votave të KPF-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë jam mundu me sqaru disa here me radh, mirpo edhe nese nuk mer shumicen e votave do të shkoj në kuvend sepse kryetari kur e propozon një pikë e sjellë edhe për KPF edhe për kuvend .Mirpo pikat që janë për shqyrtim që kanë defekte dhe mungesë dokumentacioni dhe në KPF mund të marim vendim që ato pika të kthehen mbrapa dhe të refuzohen në kuvend.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 7 vota pro, 2 anëtar nuk marrin pjesë në votim,

Rendi i Ditës

- 1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.12.2024.
- 3.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.
- 4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.
- 5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës se Pejës për vitin 2024.
- 6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të KKSB-së për vitin 2024.
- 7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.
- 8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.
- 9 .Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 16.12.2024

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim miratohet procesverbali i KPF-së i dt.16.12.2024.

3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr ne senacën e kuvendit edhe kryetari ka me prezentu informaten mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës së Pejës.

Z.Berat Ganiqi: secili ktu e përfaqësojmë një subjekt politik dhe secili është pjesë e fushates të subjektit të tij. Mirpo kur e kanë marr komunën me udhëheq pse nuk po i përgjigjen edhe qytetarëve dhe obligimeve ligjore që i kanë, sespe kjo është pikë që ish dasht me u raportu qoftë

nga kryetari ose nga delegimi i tij. Por këtu kanë kandidu krejt dhe ketu e kam hallin që komuna është braktisë, lemo nga njerzit që e udhëheqin por edhe nga punëtorët sespe po i shohim çdo ditë në fushata. Kishte me qen mirë me i kry punët dhe anen ligjore që j'u takon sepse në të gjitha këto pika janë duke mungu!

Nga të gjithë anëtarët prezent 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informata e kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: plani i punes së ekzekutivit brenda vetes i përmban brenda vetit planet e seciles drejtori për realizimin e objektivave për vitin 2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit informata e kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës se Pejës për vitin 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një raport që ju ka ardh të gjithëve dhe paraqet punen e seciles drejtori gjatë vitit 2024, nese ka dikush diqka po e hapim diskutimin!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit informata mbi raportin vjetor të Komunës se Pejës për vitin 2024.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të KKSB-së për vitin 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: KKSB-ja mban 7 takime obligative brenda vitit marin pjesë arter të ndryshem të institucioneve prej Policisë, Bashkësive Fetare, dhe shoqerisë civile dhe e kanë obligim me na sjellë raportin në fund të vitit.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit raporti i KKSB-së për vitin 2024.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit informata mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.

8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.

Znj Hajrije Haxhijaj: është raporti vjetor i shpenzimit të buxhetit dhe fillimisht po tregoj që buxheti është shpenzu 98.30% totali i përgjithshëm. Po ashtu mund të them se është një realizim i kënaqshëm dhe kemi arrit që Grantin qeveritar kemi arrit ta shpenzojmë afër 99%. Të hyrat vetanake më pak janë shpenzu për arsye se të hyrat e muajit dhjetor është e pamundshëm të shpenzohet komplet. Kemi një tejkalim të planit të të hyrave, ku të hyrat së bashku me donacionet kanë arrit shumë 7,524.99.00 d.mth 40 % të realizimit të planit të hyrave. Meqenëse kemi edhe tejkalim të planit të të hyrave përafersisht 1 milionë. Kjo është shuma e gjithëanshme duke i përfshi edhe donacionet ! Edhe pse donacionet nuk hyn tek të hyrat vetanike por vetem i kemi si realizim të paraqitura në këtë raport. Shpenzimi i krejt buxhetit në të gjitha fondet ktu është e paraqitur sa është realizuar grandit qeveritar, mjetet e bartura, donacionet e mbredshme, të hyrat vetnake ku gjithësej është 98.30% apo 42,478,534 euro. Duhet të cekim që është edhe një realizim i kënaqshëm i investimeve kapitale, ku e perbejnë një përqindje të realizimit prej 95.51% 13,881.847.13 euro.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit raporti i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.

9. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

Znj.Zize Hakaj Veselaj: deshta me ngrit një çështje për shendetësinë, tani po bëhen afër 1 muaj që në ambulanta nuk e kemi terapin elementare! Besom që jeni duke ra para popollit shumë keq edhe ju qe jeni në qeverisje edhe kta që janë nelt. Unë, e di që prej ministrisë së shendetësisë vin barnat, por edhe komuna mundet me i siguru gjërat elementare. Kur nuk i ki gjërat elementare diklofen, tretje, dexason nuk e di qysh me hap deren e ambulantes!

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:35 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUESI,

z. Rexhep Kurtbogaj

